



Titulli i projektit

Zhvillimi i Agro-turizmit

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik

Vendndodhja e projektit

Shijak, Maminas, Xhafzotaj dhe Gjepalaj

Buxheti i paravlerësuar

240,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Një nga sektorët me potenciale të qarta për zhvillimin ekonomik të Zonës Funksionale Shijak është ai i turizmit, deri më tani krejtësisht i pashfrytëzuar. Ky sektor, i kombinuar me potencialet e tjera të zonës, siç është bujqësia dhe blegtoria, do të krijonte mundësinë e realizimit të aktiviteteve pilot në fushën e agro-turizmit, bazuar në traditat dhe prodhimet vendase.

Siç del qartë edhe nga analiza e Zonës Funksionale Shijak, prodhimet bujqësore dhe blegtorale janë baza e ekonomisë. Ndaj kjo nismë do krijojë hapësira të reja për rritjen e prodhimit vendas, promovimin e tij dhe nxitjen e zhvillimit të turizmit me fokus produktet lokale. Ky kombinim i një sektori të pazhvilluar në zonë, siç është turizmi, me dy sektorë të tjerë që përbëjnë bazën e ekonomisë lokale, do të sillte suksesshëm rritjen e të gjithë sektorëve të përfshirë.

Qëllimi/et specifik të projektit

Objekti i këtij projekti është zhvillimi dhe promovimi i qëndrueshëm i turizmit nëpërmjet mbështetjes dhe krijimit të fermave pilot për nxitjen e aktiviteteve agro-turistike, si një destinacion i ri turistik.

Nxijtja e zhvillimit ekonomik të zonës nëpërmjet kombinimit të këtyre dy sektorëve ekonomikë, e ndërlikur edhe me përfitimet direkte të 40 fermave të përzgjedhura.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Përfituesit direktë të këtij projekti janë 40 fermat e përzgjedhura për të krijuar hartën e destinacioneve agro-turistike dhe në përgjithësi i gjithë komuniteti i Zonës Funksionale Shijak. Të gjitha NJQV e Zonës Funksionale Shijak do të jenë njëloj të përfshira në aktivitetet e projektit, 10 ferma për secilën.

Përfitimet ekonomike të zonës do të vijnë nga zhvillimi i agro-turizmit si destinacion i ri turistik dhe rritja e numrit të turistëve ditorë me 200 persona gjatë vitit të parë.

PROJEKTI 2



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e projektit do të jetë 20 muaj.

- Mbështetja me teknologji dhe pajisje e 40 fermave të identifikuara dhe përzgjedhura.
- Krijimi i hartës agro-turistike me destinacionet e fermave dhe produktet e tyre.
- Promovimi i hartës agro-turistike dhe përfshirja në axhendat turistike të operatorëve vendas dhe të huaj.
- Ngritja e zyrave të informacionit turistik në 4 NJQV e Zonës Funksionale.
- Panairi me produktet tradicionale, bujqësore dhe blegtorale të zonës dhe nxitja e krijimit të një date të përvitshme për një festë lokale.

Maturimi i projektit

Ka vetëm një koncept të qartë për nevojën dhe mundësitë që do të ofronte zbatimin e këtij projekti. Për zbatimin e këtij projekti, hapi i parë që duhet të ndërmerret është marrëveshja me pushtetin vendor dhe fermerët.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Duke marrë në konsideratë pamundësitë financiare të pushtetit vendor për financimin e projekteve të kësaj natyre, do të ishte e përshtatshme që të kërkohej financim nga donatorët e huaj dhe fondet e zhvillimit të rajoneve të Qeverisë Shqiptare.

Shoqëria civile, në partneritet me pushtetin vendor, do të ishte aktori më i përshtatshëm për zbatimin e këtij projekti, duke marrë në konsideratë edhe përvojën e grumbulluar ndër vite dhe rolin e saj të natyrshëm në projekte të tilla.

Kostot e projektit

Mbështetja me teknologji dhe pajisje e 40 fermave	160,000
Krijimi i hartës agro-turistike	10,000
Promovimi i hartës	10,000
Ngritja e zyrave të informacionit turistik në 4 NJQV e ZF	50,000
Organizimi i Panairit	10,000